

MUNGESA E TRANSPARENCËS MINIMALE, PËRBALLË PREMTIMIT PËR TRANSPARENCË RADIKALE

(Analizë e nivelit të transparencës së Zyrës
së Presidentit, Kuvendit dhe Qeverisë)



Autor: Gzim Shala dhe Aurela Mërlaku
Redaktor: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështje të Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Zbatimit dhe Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD
Rr. Ilaz Agushi Prishtinë
E: info@kli-ks.org www.kli-ks.org
www.kli-ks.org

Dhjetor, 2023
Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	5
2. Metodologjia	6
3. Zyra e Presidentit	7
4. Kuvendi	7
5. Qeveria	7
5.1. Transparenca e Qeverisë	7
5.2. Zbatimi i Rregullores për Konsultime Publike	13
6. Ministritë më transparente	15
7. Ministritë më jo-transparente	15
8. Shtojcat	16
8.1. Shtojca 1: Rangimi i institucioneve sipas transparencës	16
Shtojca 2: Indikatorët e aplikuar për matjen e transparencës	17

Lista e Shkurtesave

AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
ME	Ministria e Ekonomisë
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJD	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës
MSh	Ministria e Drejtësisë
MZhR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ZKM	Zyra e Kryeministrit

1. Përmbledhje ekzekutive

Qeveria aktuale ka ardhur në pushtet me premtimin për “qeverisje radikale”. “Qeverisja jonë do të jetë e hapur dhe transparente para qytetarëve, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile. Iniciativat dhe vendimet qeveritare do t’i bëjmë të qasshme për publikun dhe do t’i konsultojmë me të gjitha palët e interesit. Do të plotësojmë kornizën ligjore për përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies së financimit të subjekteve politike dhe menaxhimin e mbrojtjes së informacionit të klasifikuar” thuhet në Programin Qeverisës së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025.

Përballë këtyre premtimeve, ligjeve dhe rregulloreve në fuqi dhe nevojës së madhe për transparencë, qeverisja aktuale duket se ende nuk ka arritur standardet minimale të transparencës publike. Aq më pak, një “transparencë radikale”.

Gjetjet e Institutit të Kosovës për Drejtësi dëshmojnë se kur po bëhen tri vite që nga ardhja e Qeverisë aktuale në pushtet, institucionet qeveritare ende nuk kanë arritur të plotësojnë standardet minimale të transparencës, e aq më pak një transparencë radikale.

Kuvendit dhe Presidencës i mungojnë të dhënat në lidhje me zyrtarët për qasje në dokumente publike. Po ashtu, këtë obligim nuk e kanë përmbushur as gjysma e dikastereve qeveritare.

Mungesë e theksuar e transparencës së institucioneve qeveritare vërehet në raport me publikimin e vendimeve të ministrave. Nga të gjitha institucionet qeveritare, të gjitha vendimet e nxjerra janë publikuar vetëm në rastin e Qeverisë. Janë gjithsej 10 ministri të cilat në faqen e tyre zyrtare nuk kanë të publikuar asnjë vendim të nxjerrë nga Ministri. IKD po ashtu gjeti se në shumë raste, faqet zyrtare të Qeverisë nuk përmbajnë të dhënat e plota në lidhje me Ministrat dhe kabinetet e tyre, përfshirë edhe kontaktet e tyre.

Në kuptim të zbatimit të obligimeve ligjore dhe veçanërisht premtimeve për “transparencë radikale”, problematike del të jetë edhe qasja në dokumente publike. Gjatë periudhës kohore Janar – Shtator 2023, në AIP u parashtuan gjithsej 120 ankesa për qasje në dokumente publike. Në 71 prej këtyre rasteve, qasja në dokumente publike u mundësua vetëm pas parashtimit të ankesës në AIP, në të cilat raste AIP nxjerri vendime përmbyllëse. Ndërsa, në 17 raste, AIP nxjerri vendime detyruese për qasje në dokumente publike.

Përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport, sipas përgjigjeve të dikastereve qeveritare, janë miratuar gjithsej 165 dokumente të cilat sipas Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik i nënshtrohen konsultimeve publike. Nga 165 akte të tilla, në platformën e konsultimeve publike janë publikuar vetëm 110 prej tyre. Pra, 55 projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative janë miratuar pa u zhvilluar fare proces i konsultimit publik.

Progres evidentohet në respektimin e afatit minimal të konsultimeve publike. Gjetjet e monitorimit të IKD flasin për respektim të afatit minimal të konsultimeve publike në të gjitha rastet e konsultimeve publike gjatë vitit 2023.

2. Metodologjia

Me qëllim të matjes së transparencës së institucioneve, Instituti i Kosovës për Drejtësi ka ndërtuar një metodologji të thjeshtëzuar për të matur transparencën e përgjithshme të institucioneve. Indikatorët në fjalë janë nxjerrë kryesisht nga Ligji Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe nga Rregullorja (QRK) Nr.05/L-2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik. Këta indikatorë, janë përfshirë në shtojcën 2 të këtij raporti.

Sa i përket rangimit të institucioneve, kalkulimi i pikëve, për indikatorët 1, 2, 4, 5, 8 dhe 9, të paraqitur në shtojcën 2, është bërë në këtë mënyrë: Obligim i përmbushur – 2 pikë, pjesërisht i përmbushur – 1 pikë dhe i papërmbushur 0 pikë. Në rastin e indikatorit 8 dhe 9, në rastin kur institucionet qeveritare nuk kanë miratuar asnjë dokument që i nënshtrohet procesit të konsultimeve publike, të dy indikatorët janë zbatuar me nga 2 pikë. Me qëllim të shmangies së llogaritjeve abstrakte, për disa indikatorë, është bërë poentim më i përshkallëzuar i vlerës së indikatorit. Kështu, për indikatorin 3, vlerësimi është bërë në këtë mënyrë: 0% deri në 20% - 0 pikë, 21% deri në 40% 1 pikë, 41% deri në 60% 2 pikë, 61% deri në 80% 3 pikë dhe 81% deri në 100% 4 pikë. Sa i përket indikatorit 6 dhe 7, poentimi është bërë në këtë mënyrë: 0 deri në 4 raste – 4 pikë, 1 deri në 4 raste 3 pikë, 5 deri në 8 raste 2 pikë, 8 deri në 12 raste 1 pikë, mbi 12 raste 0 pikë.

Indikatorët janë aplikuar në mënyrë uniforme ndaj të gjitha institucioneve që janë pjesë e vlerësimit të këtij raporti, përkatësisht Zyrës së Presidentit, Kuvendit dhe Qeverisë. Në rastin e Qeverisë, janë aplikuar dy kritere shtesë sipas Rregullores (QRK) Nr.05/L-2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik.

Burimi primar i të dhënave të këtij raporti janë faqet zyrtare të institucioneve dhe platforma e konsultimeve publike. Përtej kësaj, IKD përmes kërkesave për qasje në dokumente publike ka siguruar disa prej të dhënave statistikore të cilat kanë mundësuar draftimin e këtij raporti.

Ky raport i referohet transparencës lidhur me të dhënat 1 janar – 20 tetor 2023.

3. Zyra e Presidentit

Në faqen zyrtare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës janë të publikuara të dhënat bazë në lidhje me këtë institucion si dhe janë të publikuara të dhënat në lidhje me Presidenten dhe kabinetin e saj. AIP gjatë vitit 2023 nuk ka pranuar ankese për qasje në dokumente publike ndaj Zyrës së Presidencës. Ndërkaq, në faqen zyrtare të Presidencës nuk janë të publikuara të dhënat lidhur me zyrtarin për qasje në dokumente publike.

5. Qeveria

Në bazë të indikatorëve të përcaktuar, IKD ka matur edhe nivelin e transparencës së Qeverisë, përkatësisht Zyrës së Kryeministrit dhe të gjitha Ministrive. Për dallim nga rastet e tjera, në rastin e qeverisë, është monitoruar edhe niveli i Zbatimit të Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik.

Në raportin e kaluar, vlerësimi nuk ishte bërë në raport me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Kjo për faktin se kjo Ministri, në kundërshtim me Ligjin, nuk kishte fare faqe zyrtare përmes të cilës publiku mund të informohet mbi kompetencat dhe punën e këtij institucioni qeveritar.¹ Pas publikimit të raportit të IKD-së, tanimë kjo Ministri ka hapur faqen e saj zyrtare dhe si rrjedhojë në këtë raport është pjesë e vlerësimit.

4. Kuvendi

Kuvendi i Republikës së Kosovës në faqen e vet zyrtare i ka të publikuara të dhënat bazë derisa ka të publikuara edhe të dhënat mbi Kryetarin e Kuvendit dhe Kabinetin e tij.

Në faqen e Kuvendit nuk ka të dhëna lidhur me zyrtarin për qasje në dokumente publike. Sipas të dhënave të AIP, në dy raste, qasja në dokumente publike është mundur vetëm pas vendimit detyrues të nxjerrë nga AIP.

5.1. Transparenca e Qeverisë

Neni 5.2. i Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka përcaktuar të dhënat bazë të cilat duhet të përmbajnë të gjitha faqet zyrtare të institucioneve publike.

Sa i përket të dhënave bazë të institucionit, të gjitha dikasteret qeveritare përmbajnë këto të dhëna. Përfshirë në këtë rast bënë vetëm ZKM dhe MPJD të cilat vetëm pjesërisht e kanë përmbushur këtë obligim.

Tutje, neni 13.1 i Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike përcakton se “Të gjitha institucionet publike detyrohen të caktojnë njësinë apo një zyrtar përgjegjës për qasje në dokumente publike”.

Sa i përket zyrtarëve për qasje në dokumente publike, IKD ka hulumtuar nëse institucionet qeveritare kanë të publikuara në faqet e tyre zyrtare emrat dhe kontaktet e këtyre zyrtarëve. Tetë institucione qeveritare kanë publikuar të dhëna në lidhje me emrin dhe kontaktet e zyrtarit për qasje në dokumente publike derisa tetë të tjera nuk e kanë bërë këtë. Shprehur në përqindje i bie se këtë obligim nuk e kanë zbatuar gjysma e institucioneve qeveritare.

¹ “(Mos) Transparenca në Qeverisje”. IKD. Dhjetor 2022, f.5. (Shih linkun: https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/SHQIP-FINAL-Raporti_Barometri-i-transparences_Qeveria-2.pdf). (Qasur për herë të fundit më 5 dhjetor 2023).

Institucioni		A janë publikuar emri dhe kontaktet e zyrtarit për qasje në dokumente publike?
ZKM	Po	
MFPT	Jo	
MD	Po	
MSh	Po	
MAShTI	Jo	
MKRS	Jo	
MAPL	Po	
MMPHI	Jo	
MBPZhR	Po	
MM	Po	
MPB	Jo	
MINT	Jo	
ME	Po	
MKK	Jo	
MZhR	Jo	
MPJD	Po	

Tabela 1: Publikimi i emrit dhe kontakteve të Zyrtarit për Qasje në Dokumente Publike.

Sa i përket publikimit të emrit dhe kontakteve të Zyrtarit për Qasje në Dokumente Publike, në momentin kur janë nxjerrë të dhënat nga faqet zyrtare të Ministrive, MAShTI nuk i ka pasur të publikuara këto të dhëna. Në momentin kur ky raport, si Draft, është dërguar për komente, zyrtarja e këtij institucioni ka theksuar se të dhënat janë të publikuara në faqen zyrtare të kësaj Ministrie, duke kërkuar korrektësi². Kjo përkundër faktit që publikimi i këtyre të dhënave është

² Përgjigje e MAShTI për IKD, 6 Dhjetor 2023

bërë vetëm pasi Draft Raporti i IKD është dërguar për komente, për të cilin fakt IKD posedon edhe prova. Dy ditë më vonë, e njëjta zyrtare ka dërguar përsëri email, ku ka dërguar linkun si dhe ka theksuar se është bërë përmirësimi, në atë mënyrë që këto të dhëna janë publikuar ³.

Mungesë e theksuar e transparencës së institucioneve qeveritare vërehet në raport me publikimin e vendimeve të ministrave. Nga të gjitha institucionet qeveritare, të gjitha vendimet e nxjerra janë publikuar vetëm në rastin e Qeverisë.

Janë gjithsej 10 ministri të cilat në faqen e tyre zyrtare nuk kanë të publikuar asnjë vendim të nxjerrë nga Ministri. Ndërsa, institucioni qeveritar me përqindjen më të lartë të vendimeve të publikuara, pas Qeverisë, është Zyra e Kryeministrit, e cila ka publikuar vetëm 38.1% të vendimeve të nxjerra nga Kryeministri.

Institucioni	Numri i vendimeve të nxjerra nga Ministri	Numri i vendimeve të publikuara	% e publikimit të vendimeve
Qeveria	424	424	100%
ZKM	42	16	38.1%
MFPT	53	7	9.72%
MD	72	7	0%
MSh	153	0	5.35%
MAShTI	112	6	6.74%
MKRS	178	12	/
MAPL	/ ⁴	0	0%
MMPHI	5	0	0%
MBPZhR	163	0	0%
MM	462	0	0%
MPB	165	0	0%
MINT	/ ⁵	7	/
ME	48	0	0%
MKK	85	0	0%
MZhR	9	0	0%
MPJD	164	0	0%

Tabela 2: Publikimi i vendimeve të Ministrave.

³ Po aty, 8 Dhjetor 2023.

⁴ Shënim: IKD ka dërguar kërkesë për informata në MAPL lidhur me numrin e vendimeve të nxjerra nga Ministri i MAPL. Të njëjtit fillimisht nuk kanë kthyer përgjigje, me ç'rast IKD i është drejtuar AIP me ankesë. Pas parashtrimit të ankesës në AIP, MAPL ka kthyer përgjigje në pyetjet e tjera të kërkesës, por jo edhe në atë lidhur me numrin e vendimeve të nxjerra nga Ministri i MAPL.

⁵ Shënim: IKD ka dërguar kërkesë për informata në MINT lidhur me numrin e vendimeve të nxjerra nga Ministria e MINT, por se nuk ka marrë përgjigje. Për këtë, IKD ka parashtruar ankesë në AIP.

Sipas Kushtetutës dhe Ligjit, institucionet qeveritare duhet ta zbatojnë parimin e dygjuhësisë në dokumentet e publikuara. Me këtë rast, IKD ka analizuar nëse në faqet zyrtare të institucioneve qeveritare janë të publikuara dokumentet e ndryshme në të dy gjuhët. Përgjatimisht Qeverisë dhe Zyrës së Kryeministrit, asnjë institucion tjetër qeveritar nuk e ka plotësuar në plotëni këtë obligim qeveritar.

Duhet theksuar se publikimi i vendimeve në të dy gjuhët, fillimisht, është obligim kushtetues dhe ligjor. Përtej kësaj, në institucionet e Republikës së Kosovës janë të angazhuar një numër i konsiderueshëm i zyrtarëve serb. Mos publikimi i dokumenteve në gjuhën serbe, gjuhë kjo zyrtare në Republikën e Kosovës, u pamundëson të njëjtëve që të njihen me dokumentet, të cilat potencialisht mund të kenë impakt në punën e tyre.

Tutje, IKD ka analizuar faqet zyrtare të dikastereve qeveritare për të parë nëse në faqet e tyre zyrtare janë të publikuara të dhënat dhe kontaktet në lidhje me Ministrat dhe Kabinetet e tyre.

Në këtë rast, IKD ka gjetur se këto të dhëna janë pjesë e 10 faqeve zyrtare të institucioneve qeveritare. Pjesërisht, këto të dhëna janë publikuar nga pesë institucione qeveritare derisa një institucion qeveritar nuk e ka përmbushur fare këtë obligim. Shprehur në përqindje i bie se 62.5% i dikastereve qeveritare i kanë publikuar të dhënat në fjalë, 31.25% të tyre i kanë publikuar vetëm pjesërisht këto të dhëna, derisa 6.25% të tyre nuk i kanë publikuar fare këto të dhëna.

Përkundër që mos publikimi apo publikimi i pjesshëm i këtyre të dhënave nga dikasteret qeveritare vazhdon të paraqesë problematike, IKD gjenë se në raport me vitin paraprak ka një progres në këtë pjesë. Kjo pasi në raportin e kaluar, IKD kishte gjetur se përqindja e institucioneve qeveritare që kanë publikuar këto të dhëna është 33.3%, derisa këtë vit kjo përqindje është rritur për 22.95%, përkatësisht në 56.25%.

Institucioni	ZKM	Pjesërisht	Publikimi i të dhënave të Ministrave dhe kabineteve
	MFPT	Pjesërisht	
	MD	Pjesërisht	
	MSh	Po	
	MAShTI	Po	
	MKRS	Po	
	MAPL	Po	
	MMPHI	Po	
	MBPZhR	Po	
	MM	Po	
	MPB	Po	
	MINT	Po	
	ME	Po	
	MKK	Pjesërisht	
	MZhR	Po	
	MPJD	Pjesërisht	

Tabela 3: Publikimi i të dhënave lidhur me udhëheqësit e institucioneve, përfshirë edhe kabinetet.

Në kuptim të zbatimit të obligimeve ligjore dhe veçanërisht premtive për “transparencë radikale”, problematike del të jetë edhe qasja në dokumente publike. Gjatë periudhës kohore Janar – Shtator 2023, në AIP u parashtruan gjithsej 120 ankesa për qasje në dokumente publike. Në 71 prej këtyre rasteve, qasja në dokumente publike u mundësua vetëm pas parashtrimit të ankesës në AIP, në të cilat raste AIP nxjerri vendime përmbyllëse. Ndërsa, në 17 raste, AIP nxorri vendime detyruese për qasje në dokumente publike. Në 10 raste, ankesat u refuzuan nga AIP derisa 23 ankesa janë në proces të shqyrtimit nga AIP.

MKRS del të jetë dikasteri qeveritar me numrin më të madh të ankesave ndaj saj. Madje, vetëm ndaj këtij dikasteri Qeveritar, AIP gjatë vitit 2023 nxjerri 6 vendime detyruese, derisa në 12 raste të tjera, qasja në dokumente publike u mundësua vetëm pas parashtrimit të ankesës në AIP.

Përkundër nxjerrjes së vendimit detyrues, MMPHI në një rast nuk zbatoj vendimin e AIP, me ç'rast AIP i shqiptoj gjobë.

Në raport me vitin paraprak, institucionet qeveritare kanë shënuar një progres në këtë fushë. Mirëpo, përballë këtyre të dhënave, shihet se institucionet qeveritare ende mbesin larg zbatimit të standardeve minimale të transparencës. Aq më pak, “transparencën radikale”.

Institucioni	Nr. i ankesave	Vendime përmbyllëse	Vendime detyruese	Vendime refuzuese	Në proces
MKRS	21	12	6	2	1
MMPHI	18	8	5	0	4
MASHTI	14	5	1	1	7
MPB	12	7	2	0	3
MPJD	11	10	0	1	0
MINT	10	4	3	1	2
ZKM	9	7	0	1	1
MFPT	9 ²	6	0	2	1
MSh	6	6	0	0	0
MD	5	2	0	2	1
MBPZhR	2	2	0	0	0
ME	2	1	0	0	1
MM	1 ³	1	0	0	0
MKK	1	0	0	0	1
MZhR	1	0	0	0	1
MAPL	0	0	0	0	0
Total	120	71	17	10	23

Tabela 4: Trajtimi i kërkesave për qasje në dokumente publike.

5.2.Zbatimi i Rregullores për Konsultime Publike

Rregullorja (QRK) Nr. 05/2016 për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik [neni 5] (Tutje: Rregullorja) ka përcaktuar se, ndër të tjera, projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative i nënshtrohen procesit të konsultimit publik. Sipas kësaj rregullore [neni 9.1] konsultimi publik duhet të jetë i hapur për jo më pak se 15 ditë pune. Rregullorja [neni 16] përcakton se shmangie nga kjo rregull mund të ketë vetëm në rastet e emergjencave publike dhe rasteve të tjera të përcaktuara me ligj.

Përgjatë periudhës kohore që mbulon ky raport, sipas përgjigjeve të dikastereve qeveritare, janë miratuar gjithsej 165 dokumente të cilat sipas Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik i nënshtrohen konsultimeve publike. Nga 165 akte të tilla, , në platformën e konsultimeve publike janë publikuar vetëm 110 prej tyre. Pra, 55 projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative janë miratuar pa u zhvilluar fare proces i konsultimit publik⁶. Shprehur në përqindje i bie se përballë obligimit që të gjitha këto akte të publikohen për konsultim publik, dikasteret e Qeverisë e kanë bërë këtë në 66.66% të rasteve derisa këtë nuk e kanë bërë në 33.3% të rasteve të tjera.

Krahasimisht me vitin e kaluar, kjo përqindje është ngritur për 11.46%. Përkundër të saj, këto të dhëna flasin për vazhdim të mungesës të transparencës në fushën e politikë-bërjes. Rregullorja për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik dhe funksionalizimi i platformës së konsultimeve publike kanë për qëllim ngritjen e nivelit të përfshirjes së publikut në politikë-bërje, në mënyrë që draftimi i politikave të ndjekë një qasje sa më gjithëpërfshirëse. Mos përfshirja e publikut në 1/3 e akteve, të cilat sipas Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik duhet ti nënshtrohen konsultimit publik, krijon përceptim për mos interesim të publikut për përfshirje të publikut të gjerë në politikë-bërje.

Sa i përket 110 rasteve kur projekt koncept dokumentet dhe projekt aktet normative janë publikuar për konsultime publike në platformën e konsultimeve publike, IKD tanimë ka evidentuar progres të plotë në këtë drejtim. Për dallim nga viti paraprak, kur afati për konsultime publike nuk ishte respektuar në 13% të rasteve, gjatë këtij viti institucionet qeveritare kanë respektuar këtë afat në të gjitha rastet.

⁶ Shënim: Për disa nga projekt koncept dokumente dhe projekt akte normative është zhvilluar konsultimi publik nga Qeveria/të paraprake. Nisur nga fakti se të gjitha iniciativat kthehen në pikën zero dhe kërkohet miratim/ri miratim i Qeverisë, konsultimi publik, në përputhje me Rregulloren për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik duhet të zhvillohet përsëri. Për miratimin e akteve të reja të cilat bazohen në agjendë të re, nuk mund të konsiderohet i konsumuar procesi i konsultimit publik mbi bazën e dokumenteve të kaluara, të bazuara në agjenda legjislative të cilat tanimë nuk janë në fuqi.

Institucioni	Numri i projekt koncept dokumenteve dhe projekt akteve normative të miratuara		Sa prej tyre janë publikuar në platformën e konsultimeve publike?		Në sa prej tyre është respektuar afati minimal?	
ZKM		5		3		3
MFPT		19		3		3
MD		23		16		16
MSh		22		9		9
MAShTI		14		13		13
MKRS		1		1		1
MAPL		6		6		6
MMPHI		21		14		14
MBPZhR		14		14		14
MM		2		2		2
MPB		18		9		9
MINT ⁷		/		17		17
ME		8		6		6
MKK		0		0		0
MZhR		0		0		0
MPJD		0		0		0
Total		165 ⁸		110		110

Tabela 5: Respektimi i Rregullores për Standardet Minimale në Procesin e Konsultimit Publik nga dikasteret qeveritare

7 Shënim: IKD ka dërguar kërkesë për informata në MINT lidhur me numrin e akteve të miratuara, të cilat i nënshtrohen procesit të konsultimeve publike. MINT nuk ka kthyer përgjigje në këtë kërkesë. IKD ka parashtruar ankesë në AIP.

8 Shënim: Në total, sipas përgjigjeve të pranuara, janë 148 dokumente. Këtu përjashtohet MINT, që nuk ka kthyer përgjigje në kërkesën e AIP, për të cilin rast IKD ka parashtruar ankesë në AIP. Por, totalit prej 148 dokumenteve, i janë shtuar 17 dokumente të publikuara nga MINT për konsultime publike në platformën e konsultimeve publike.

6. Ministritë më transparente

Në bazë të indikatorëve të shpjeguar në metodologjinë e këtij raporti, rezulton se sikurse në vitin e kaluar, edhe gjatë këtij viti MBPZhR del të jetë dikasteri qeveritar më transparent, e cila ka grumbulluar gjithsej 20 pikë, nga 30 gjithsej. Indikatori më negativ i kësaj Qeverie rezulton të jetë mos publikimi i vendimeve të Ministrit. Mirëpo, gjatë fazës së konsultimeve publike, kjo Ministri e ka informuar IKD-në se pas fillimit të realizimit të këtij hulumtimi, ka ndërmarrë veprime për publikimin e këtyre vendimeve⁹. Në fakt, tanimë një numër i konsiderueshëm i vendimeve të Ministrit të MBPZhR janë të publikuara në faqen zyrtare.

Për dallim nga viti paraprak që ishte ranguar e teta, MAPL ka bërë avancim në këtë vit, duke u renditur si dikasteri i dytë qeveritar më transparent. MAPL ka grumbulluar 19 nga pikë.

Ndërsa, në vendin e tretë janë ZKM dhe MM, me nga 18 pikë, nga gjithsej 30.

7. Ministritë më jo-transparente

MMPHI dhe MFPT dalin të jenë Ministritë më jo transparente. Nga totali prej 30 pikëve, në bazë të indikatorëve të aplikuar, këto Ministri kanë mbledhur vetëm nga 11 pikë.

Pas këtyre, Ministritë më jo transparente në bazë të këtyre indikatorëve janë MINT dhe MKRS që nga totali prej 30 pikëve kan arritur të mbledhin nga 12 pikë.

⁹ Përgjigje e MBPZhR për IKD, 8 Dhjetor 2023.

8. Shtojcat

8.1.Shtojca 1: Rangimi i institucioneve sipas transparencës

Institucioni		Pikët (Nga totali prej 30)
MBPZHR		20
MAPL		19
ZKM		18
MM		18
ME		17
MD		16
MZhR		16
MSh		15
MPB		15
MKK		15
MAShTI		14
MPJD		14
MKRS		12
MINT		12
MFPT		11
MMPHI		11

Tabela 6: Rangimi i institucioneve sipas transparencës.

Shtojca 2: Indikatorët e aplikuar për matjen e transparencës

1. A janë publikuar të dhënat bazë mbi institucionin ?
2. A është publikuar emri dhe kontaktet e zyrtarit për qasje në dokumente publike?
3. A janë të publikuara vendimet e Ministrave? (Aplikohet vetëm për Qeverinë)
4. A janë të publikuara të gjitha dokumentet në dy gjuhët zyrtare?
5. A janë publikuar të dhëna mbi emrat dhe kontaktet e zyrtarëve udhëheqës të institucionit, përfshirë edhe Kabinetet?
6. Sa vendime përmbyllëse ka nxjerrë AIP?
7. Sa vendime detyruese ka nxjerrë AIP?
8. A janë publikuar të gjitha dokumentet për konsultim në platformën e konsultimeve publike?
9. A është respektuar afati minimal i vendosjes së akteve në konsultim publik?